REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. M32/20
Datë/Datum. 18.01.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Gjemajli Bellanica; G. Bellanica	25.12.2020	06.01.2021	1132/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.12.2020, OE **"Vitech" SH.P.K -Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: 1122/20 kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit te prokurimit me titull **"Furnizim me pajisje laboratorike në KRU Hidro morava Gjilan dhe KRU Bifurkacioni Ferizaj"** , me nr. të prokurimit: **020-7555-5-2-1** , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - CDI.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Punë, vlera e parashikuar e kontratës: **70 000.00** €.

Data e njoftimit për kontratë.....02.12.2020.
Data e njoftimit për anulim të aktivitetit te prokurimit.....23.12.2020.

Data e Ankesësë në OSHP.....23.12.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE **"Vitech" SH.P.K - Prishtinë**

Dispozitat e shkelura

Neni 7 - Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 28 - Specifikimet teknike
Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Me datë 21.12.2020 kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK dhe nuk kemi marre asnje pergjigje.

1.

-Bazuar ne dosjen e tenderit tek KERKESA 3. Certifikatat dhe Standardet Nderkombetare

- Operatoret Ekonomike (konzorciumet ne ten-en, aplikimi i ri) duhet te paraqesin nje certifikate qe eshte ne perputhje me (i)Certifikatat ISO 9001 per Menaxhimin e Cilesise; (ii) Certifikatat ISO 14001 per Menaxhimi i Mjedisit; (iii) ISO 45001 per menaxhimin e sigurise dhe shendetit ne pune (bosht OHSAS 1800.

Bazuar ne kete procedure te prokurimit qe perfshine vetem fumizime me pajisje laboratorike, ne si OE konsiderojme se eshte e pa drejtë dhe diskriminuese përfshirja e ketyre ISO-ve jo relevante me natyren e artikujve te kerkuar si dhe favorizon operatore ekonomik te caktuar dhe rrjedhimisht nje trajtim jo te barabart pra ne kundershtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

2.

-Ne dosjen e tenderit te pranuar me date 21.12.2020, data e hapje se tenderit eshte ndërruar per daten 31.12.2020 ne ora 14:00, ndersa ne platformen E- Prokurimi data ka mbet e njejte sikurse me heret 23.12.2020, pra është krijuar konfuzitet ne lidhje me daten e hapjes se tenderit.

Tenderët duhet të dorezohen në adresën e specifikuar në pjesen A "Procedurat e Tenderimit para 23.12.2020 ne 14:00:00 ora.

Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po ☒ Jo ☐ *Nëse kërkohet siguria i tenderit:* Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit.
	13.2	Vlera e sigurisë së tenderit - 1000 (një mijë euro) Vlefshmëria e sigurisë së tenderit ne ditë 90 apo muaj
Siguria e ekzekutimit	14.1	Siguria e kërkuar e ekzekutimit: Po ☒ Jo ☐ *[Nëse kërkohet siguria e ekzekutimit]* Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni, para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit.
	14.2	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit duhet *[shëno shumën apo përqindjen në fjalë dhe figura]* apo 10 % e vlerës së kontratës, për koherëzgjatjen e periudhës proj *[shëno koherëzgjatjen në ditë apo muaj]*
Sqarimi i Dosjes se Tenderit	16.1	14.12.2020
Dokumentet qe përbejnë Tenderin	19.1(h)	*[Nëse është e aplikueshme shëno kërkesat tjera]*
Periudha vlefshmërisë se tenderit	21.1	Periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë: 60 dite, ose muaj, ose deri ne datën .
Afati i fundit i dorëzimit te tenderit	23.1	Afati i fundit për dorëzim është je 31.12.2020 14:00:00 Vendi: Permes E-prokurimit
Hapja e Tenderit	26.1	Hapja e tenderit do te bëhet me31.12.2020 14:00:00 Vendi: Ne zyret e CDI-së
Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët: ☒ po [Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6 ☐
Ankesat	31.3	*[shëno adresën e AK-së]*

Njoftim - 854 Formulari standard per koriggjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara

Hapa: Shiqo (F) | Web faqja | Dokument PDF

Titulli:	CDI
Referenca:	2020-20-7555-5-2-1-854-082452
Çështja:	Furnizim me paisje laboratorike ne - KRU Hidromorava - Gjilan dhe KRU Bifurkacioni - Ferizaj
Lloji i dokumentit:	854 Formulari standard per koriggjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
Lloji i kontratës:	1 Pune
CPV:	45000000-7 Pune ndërtimi
Lloji i procedurës:	1 Procedurë e hapur
Vlera e parashikuar:	70 000.00
Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje:	23.12.2020 14:00
Data e njoftimit:	22.12.2020
Data e skajarit:	31.12.2020
Logi:	LIGJI NR. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS
Dorëzimi elektronik i ofertave:	Po

Njoftimet të tjera në procedurën e njëjtën të prokurimit:

Lloji i dokumentit	Data e publikuar	Data paraqitjes
854 Formulari standard per koriggjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara	22.12.2020 00:00	31.12.2020 00:00
854 Formulari standard per koriggjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara	04.12.2020 00:00	05.12.2020 00:00
000 Njoftim per tender	30.12.2020 00:00	02.12.2020 00:00

Për të njëjtat qështje kemi bërë Kërkese per Rishqyrtim pranë Autoritetit kontraktues por nuk kemi marr përgjigjje. Kërkojme nga OSHP qe te veproje me vendosmëri dhe te mos lejoje praktika te palejueshme te kritereve per aktivitetin ne fjale te prokurimit.

KRITERETPËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

1. Regjistrimi i Subjektit Juridik Tregtar – Operatori Ekonomik (dhe secili nga anëtarët e konsorciumit, dhe

ose nënkontraktorët, nëse është e aplikueshme) duhet të jenë të regjistruar si entitetit tregtar nga organi përkatës i regjistrimit zyrtar të vendit të tij të origjinës.

2. Regjistrimi i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) – Operatori Ekonomik (ose një partner nga konsorciumi, nëse është e aplikueshme) duhet të jenë të regjistruar për TVSH-në në Administratën Tatimore nga vendit e tyre të origjinës.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1. Qarkullimi Financiar Operatori Ekonomik (ose konzorciumi në tërësi, nëse është e aplikueshme), duhet të paraqesë dëshmi për të ardhura totale bruto për tre (3) vitet e fundit deri në datën e publikimit të këtij njoftimi të kontratës së paku në vlerën prej 140,000.00 EUR.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Kontrata të natyrës të furnizimit dhe instalimit të laboratorëve me pajisje Laboratorike të përfunduara me sukses gjatë 3 (tre) viteve të fundit dhe deri në datën e publikimit të këtij njoftimi të kontratës.Vlera Totale e Kontratave duhet të jetë minimumi i vlerës prej 105,000.00 EUR.

2. Deklarata me shkrim nga OE, se artikujt për këtë projekt janë në pajtueshmëri të plotë me specifikat në aneksin 1 të dosjes së tenderit.

3. Certifikatat dhe Standardet Ndërkombëtare - Operatorët Ekonomikë (konzorciumet në terren, aplikimi i ri) duhet të paraqesin një certifikatë që është në përputhje me (i)Certifikatat ISO 9001 për Menaxhimin e Cilësisë; (ii) Certifikatat ISO 14001 për Menaxhimi i Mjedisit; (iii) ISO 45001 për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë (bosht OHSAS 18001

4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të sjellë planin dinamik për realizimin e punimeve me kohëzgjatje jo më shumë se 60 ditë pune.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

1. Certifikata e Regjistrimit i Subjektit Juridik Tregtar – Operatori Ekonomik (dhe secili nga anëtarët E konsorciumit dhe ose kontraktuesit, nëse është e aplikueshme) duhet të dorëzojë një certifikatë të vlefshme regjistrimi të entitetit tregtar nga organi përkatës i regjistrimit zyrtar të vendit të tij të origjinës.

2. Çertifikata e Regjistrimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) – Operatori Ekonomik (ose një partner nga konsorciumi, nëse është e aplikueshme) duhet të dorëzojë certifikatën valide të regjistrimit për TVSH-në të lëshuar nga Administrata Tatimore në vendin të tij të origjinës. Shënim - Nëse një Operator Ekonomik i huaj e fiton këtë tender si një ofertues individual ose si udhëheqës i një konsorciumi, atëherë Operatori Ekonomik i huaj duhet t'a regjistrojë biznesin e tij në Kosovë në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë, dhe të dorëzojë dokumentacionin e mësipërm të kërkuar para nënshkrimit të kontratës me Autoritetin Kontraktues.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1. Deklaratat Bankare – Operatori Ekonomik (ose konzorciumi në tërësi, nëse është e aplikueshme) duhet të dorëzojnë pasqyra të bankës që konfirmojnë se Operatori Ekonomik ka pasur të ardhura bruto për 3 (tre) vitet e fundit deri në datën e publikimit të këtij njoftimi të kontratës së paku në vlerën e 140,000.00 EUR .

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Lista e Kontratave natyrës së furnizimit dhe instalimit të laboratorëve me pajisje laboratorike të përfunduara me sukses gjatë 3 (tre) viteve të fundit dhe deri në datën e publikimit të këtij njoftimi të kontratës. Të bashkëngjiten referencat apo procesverbalet e pranimeve teknike që dëshmojnë se këto kontrata janë të përfunduara me sukses .Vlera totale e këtyre kontratave të jetë minimum prej 105,000.00 EUR, Referencat dhe procesverbalet duhet të përputhen me kontratat e cekura ne listën e kontratave.

2. Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.

3. Çertifikatat dhe Standardet Ndërkombëtare - Operatorët Ekonomikë (konzorciumet në terren, aplikimi i ri) duhet të paraqesin një certifikatë që është në përputhje me (i)Certifikatat ISO 9001 për Menaxhimin e Cilësisë., 3.Certifikata ISO 9001 certifikata duhet të jetë e lëshuara nga organizatat kredibile ose trupat akreditues.

4. Të dëshmohet me plan dinamik origjinal të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik Ofertues.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Anulimi bëhet sipas nenit 62 të LPP-së dhe nenit 44.7 të RRUOPP për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit.Pas një kërkese për rishqyrtim nga një OE në lidhje me specifikat teknike dhe te paramases, ne kemi analizuar në detaje paramasën dhe kemi vërejtur se ka gabime të shumta në paramasë, me të cilat gabime nuk mund të procedohet më tutje, prandaj në të ardhmen pas ndryshimeve që do të bëhen në paramasë do të vazhdohet me ritenderim të këtij aktiviteti të prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Vitech" SH.P.K -Prishtinë

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon që Certifikatat e standarteve nderkombëtare të kërkuara në kërkesën 3 tek kapacitetet teknike dhe ose profesionale,ne si OE konsiderojmë se është e pa drejtë dhe diskriminuese përfshirja e këtyre ISO-ve,jo relevante me natyrën e artikujve të kërkuara si dhe favorizon operator ekonomik të caktuar dhe një trajtim jo të barabartë.

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në platformën elektronike E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit,eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja ne sqarimet e dhëna për OE thotë se "*Duke marr parasysh qe OE ka kerkuar sqarime lidhje me kete kerkese dhe pas analizes ton ne kemi ardh ne perfundim se meqenese ne kete procedure te prokurimit nuk ka pune ndertimore por vetem furnizime me pajisje laboratorike, vetem ISO 9001 per Menaxhimin e Cilesise qe eshte relevante me natyren e ketije tenderi dhe dote mebete ne Dosjen e Tenderit dhe Njoftimi per Kontrate , ndersa ISO-te tjera: Certifikatat ISO 14001 per Menaxhimi i Mjedisit; (iii) ISO 45001 per menaxhimin e sigurise dhe shendetit ne pune (bosht OHSAS 18001) qe jane jo relevante, edhe Do te largohen nga Dosja e tenderit dhe Njoftimi pe Kontrate*".

Andaj duke marrë parasysh sistemin e E prokurimit që nuk lejon që Njoftimi për kontratë të ndryshohet me një njoftimi të ri për kontratë.Një gjë e till bëhet nëpërmjet korigjimit,formularit B54,dhe këtë formular AK-ja e ka publikuar dhe janë hequr kërkesat per certifikatat tjera dhe është si në vijim: "*Certifikatat dhe Standardet Ndërkombëtare - Operatorët Ekonomikë (konzorciumet në terren, aplikimi i ri) duhet të paraqesin një certifikatë që është në përputhje me (i)Certifikatat ISO 9001 për Menaxhimin e Cilësisë., 3. Certifikata ISO 9001 certifikata duhet të jetë e lëshuara nga organizatat kredibile ose nga trupat akreditues*".

Një pretendim i tillë është i pa bazuar për faktin se sqarimet sipas dispozitave ligjore të LPP-së, të dhëna nga AK-ja në formularin standard B54 janë pjesë e Dosjes së tenderit.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues thotë se në dosjen e tenderit të pranuar me 21.12.2020 data e hapjes së tenderit është ndërruar për datën 31.12.2020 ora 14:00, ndërsa në platformën e E prokurimit data ka mbet e njejtë sikurse më heret 23.12.2020, pra është kriju konfuzitet në lidhje me datën e hapjes së ofertave.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se në Njoftimin për Kontratë dhe në dosjen e tenderit data e hapjes së ofertave figuron data 23.12.2020, mirëpo në formularin B54 është zevendësuar data 23.12.2020 dhe është vendosur data 31.12.2020 ora 14:00, andaj sqarimet ne formularin B54 janë bërë edhe pjesë e dosjes së tenderit ashtu siç parashihet në dispozita ligjore të LPP-së, e cila është korrigjuar dhe mban datën 31.12.2020 ora 14:00.

OE ankues thotë se për të njejtat çështje kemi bërë edhe kërkesë për rishqyrtim por AK-ja nuk ka kthyer përgjigjje.
Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja është dashur të veproj konformë dispozitave të nenit 108/A të LPP-së.

Ndërsa sa i përket anulimit të aktivitetit të prokurimit,eksperti shqyrtues sqaron se arsyeja e anulimit nuk është e mjaftueshme dhe nuk plotësohen kushtet ligjore konform nenit 62 të LPP-së për anulim të aktivitetit,andaj mendoj që AK-ja duhet të veproj konform dispozitave të Nenit 53.7 të LPP-së dhe të vazhdoj me procedurat e prokurimit.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE **"Vitech" SH.P.K -Prishtinë** të aprovohet si pjesërisht e bazuar,të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me procedurat tjera të prokurimit.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues	- **CDI**
Panelit Shqyrtues	- OSHP
OE ankues	- OE **"Vitech" SH.P.K -Prishtinë**